



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:087727

Datë: 07.10.2020

Numri i dokumentit: 01169798

PKR.nr.92/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurve: Sh. K nga Prishtina dhe H. D ,Bashkia e Beratit, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, bimës së kokainës ose kanabisit nga neni 272 paragrafi 2. lidhur me 1. dhe nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s), të cilët sipas radhës i mbrojnë edhe atë të pandehurin e pare sipas autorizimit av. Haxhi Millaku nga Prishtina dhe Dr. Sc Shemsedin Pira nga Gjilani, kurse të pandehurin e dytë e mbron sipas detyrës zyrtare av. Halit Azemi nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I.nr. 89/2020 të datës 10.09.të vitit 2020, të cilën e përfaqësoi prokurori i shtetit Arben Ismajli, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 23 shtator të vitit 2020, nxjerr dhe në prani të prokurorit të shtetit si dhe të të pandehurve me mbrojtësit e tyre, në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë, duke e përpiluar aktgjykimin më datën 28.09 të vitit 2020,

A K T G J Y K I M

I.Të pandehurit :

1. SH. K. nga i ati I. dhe e ëma H. – me mbiemër të vajzërisë Sh.i, i lindur më datën... në Kamenicë, me vendbanim në Prishtinë , posedues i lejes së njoftimit me numër personal..., posedues i telefonit mobil me SIM –shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba I dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i kafiterisë ... me seli në Prishtinë, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale, posedues i lejes së njoftimit me numër personal ... (me numër të pasaportit...), të cilit është tërhiqur vërejtja që nëse eventualisht i njëjti e ndërron vendbanimin ose vendqëndrimin, është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën me shkrim ose përmes mbrojtësit të tij të autorizuar nën kërcënim të pasojave ligjore dhe

2.H.D nga i ati L. dhe e ëma T. – me mbiemër të vajzërisë Z., i lindur më datën... në Berat, , Bashkia e Beratit, Republika e Shqipërisë, ka deklaruar se nuk posedon leje të njoftimit e

ndonjë dokument personal të lëshuar nga organi kompetent i Republikës së Shqipërisë, por as numër të telefonit mobil e as të telefonit fix, ka të kryer shkollën e mesme të Gjimnazit, i papunësuar, me gjendje të dobët ekonomike, I gjykuar edhe për një veprë tjetër penale dhe dënimin e ka mbajtur por nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, I tërhiqet vërejtja se për çdo ndërrim eventual të vendabnimit ose vendqëndrimit të tij personalisht ose përmes avokatit duhet njoftoj këtë gjykatë, nën kërcënim të pasojave ligjore,

J a n ë f a j t o r ë

sepse më datën 23.07 2020 rreth orës 10:00, Komuna e Kamenicës, pas një pune operative të Policisë së Kosovës – DHTV në Gjilan, në pronën e të pandehurit Sh. K janë gjetur 540 bimë narkotike të mbjellura të kanabis sativa, në gjatësi prej 20 deri 50 cm, në atë mënyrë që të akuzuarit Sh. K dhe H. D. pa autorizim kanë kultivuar bimë narkotike të kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikëve dhe substancave psikotropiek,

- ashtu që me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale **kultivimi i bimës së hashashit, shkurrës së kokainës ose bimëve të kanabisit** nga neni 272 paragrafi 1. lidhur me paragrafin 2. dhe nenin 31 të KPRK-s.

Gjykata, në bazë të dispozitave të cituar, nenit 4, 7, 21, 31, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, dhe 72 të KPRK-s, si dhe nenin 365 të Kodit të Procedures Penale (KPP-s) të pandehurit në fjalë,

I G J Y K O N

Edhe atë :

a) të akuzuarin SH. K me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë me pëlqimin e të pandehurit Shaban, në kuptim të nenit 44 të KPRK-s i është

ZËVENDËSUAR ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 10,000 Euro, të cilën shumë duhet ta paguaj në tri këste për tre muaj edhe atë këstin e parë dhe të dytë në shuma prej nga 3,333.00 Euro, ndërsa këstin e tretë në shumën prej 3,334 Euro, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

mirëpo në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s nëse i akuzuari Sh. nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë në tërësi ose pjesërisht atëherë ky dënim

ZËVENDËSOHET me dënim me burgim duke ju llogaritur 20 Euro gjobë e barabartë me një ditë burgim, përkatësisht në kohëzgjatje prej **një viti (365 ditë) e katër muaj e 15 ditë, të cilin duhet të filloj ta mbaj** në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së ftesës nga kjo gjykatë, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

b) të pandehurin H. D me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1. (një) viti, të cilin dënim duhet të vazhdoj ta mbaj, pasi që të njëjtit i është vazhduar masa e paraburgimit gjer në plotëfuqishmëri të këtij aktgjykimi.

II.Në kuptim të nenit 79 paragrafi 1. të KPRK-s

të pandehurit Sh. K koha e kaluar në paraburgim prej datës **23.07 2020 e gjer më datën 23 shtator të vitit 2020** do t'i llogaritet në dënimin me gjobë përkatësisht në dënimin me burgim

nëse eventualisht ky i akuzuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në shumën e lartcekur, kurse

të pandehurit H. D koha e paraburgimit prej datës **23.07 2020 e gjer në plotëfuqishmëri** të këtij aktgjykimi do t'i llogaritet në dënimin me burgim.

III. Në kuptim të nenit 272 paragrafi 2. të KPRK-s KONFISKOHEN 540 fidane të bimës së kanabis sativa të cilat nga zyrtarët policor janë shkatërruar në vend të ngjarjes, pronë e të pandehurit Sh. K ndërsa

në kuptim të nenit të nenit 284 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-s **KONFISKOHET** automjeti GOLF ...E me numër të shasisë ..., me vit të prodhimit 1986, me tabela të regjistrimit ...e regjistruar sipas Certifikatës së regjistrimit të automjetit ...në emër të A. M, Komuna e Graçanicës, për ndryshe prone private e të pandehurit Sh. K i cili është sekuestruar nga ky i akuzuar më datën 23.07 2020 sipas rastit policor nga zyrtari policor – DRP DHTN nr. 2020 – DHTN-337 nga zyrtari policor A. B1 me DI

Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 487 paragrafi 3 të KPP-s një **kopje e Certifikuar e aktgjykimit të formës së prerë menjëherë i dërgohet Agjencisë ...** e cila mund të bëjë shitjen e automjetit lëndor ose dorëzimin e tij për shfrytëzim ..., meqë i njëjti menjëherë kalon në pronësi të shtetit. Ekzekutimin e kësaj pjese të aktgjykimit do ta bëjë **Sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale i kësaj gjykate.**

IV. Urdhërohet Policia e Kosovës - DRP – DHTN / Stacioni Policor në Gjilan që **Telefonin ...** të sekuestruar nga zyrtari policor me DI ... më datën 23.07 2020 t'ia kthej të pandehurit Sh. K nga Prishtina.

Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ekzekutimin e këtij urdhri do ta bëjë sektori për ekzekutimin e sanksioneve penale i kësaj gjykate.

V. DETYROHEN të pandehurit në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor edhe atë secili veç e veç në shumën prej nga **pesëdhjetë (50) Euro**, kurse në emër të taksës për kompensimin e viktimeve të krimit në shumën prej nga **pesëdhjetë (50) Euro**, të gjitha në afat prej pesëmbëdhjetë (15) dite, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti i Krimeve të Rënda në Gjilan kundër të pandehurve në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mire se të njëjtit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndore, për të cilën parashihet dënimi me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Po ashtu edhe konfiskimi i bimëve të canabis sativa, pajisjeve dhe materialeve për kultivimin e këtyre bimëve.

Kryetari i trupit gjykues menjëherë pas pranimit të lëndës penale ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar duke i ftuar palët. Në seancën e shqyrtimit fillestar mbrojtësit e të pandehurve kanë kërkuar shtyerjen e seancës për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Mbrojtësit e të pandehurve në fjalë kanë parashtruar kërkesa për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Vlen të theksohet se marrëveshja për pranimin e fajësisë përkitazi me të pandehurin e parë Sh. K është arritur dhe së bashku me aktet tjera përcjellëse i është dorëzuar kësaj gjykate, ndërsa mbrojtësi dhe i pandehuri i dytë nuk është ftuar nga organi i ndjekjes penale, duke mos paraqitur arsyet e mosftimit përfaqësuesi i aktakuzës gjatë seancës së shqyrtimit fillestar.

Në seancën e radhës të shqyrtimit fillestar për shkak të situatës së lartcekur e në anën tjetër për shkak se dy të pandehurit akuzohen për veprë penale lëndore si bashkëkryerës, kryetari i trupit gjykues në kuptim të nenit 246 të KPP-s të pandehurit fillimisht i ka njoftuar me të drejtat, ashtu që pasiqë i pandehuri Hodo Doko me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë duke u konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësinë e tij ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndore, e këtë nuk e ka kundërshtuar as mbrojtësi i tij as as prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri H. D, pasi që ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1. të KPP-s.

Pastaj është vazhduar me të pandehurin e parë Sh. K dhe në kuptim të nenit 247 ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë duke e konfirmuar prapë i njëjti se me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë në prani të mbrojtësit Haxhi Millaku në Prokurori kanë arritur marrëveshjen lëndore për pranimin e fajësisë duke u pajtuar me dënimin e rekomanduar si dhe pjesët tjera të kësaj marrëveshje.

Kryetari i trupit gjykues pasiqë ka konstatuar se marrëveshja për pranimin e fajësisë i plotëson të gjitha kushtet ligjore sipas nenit 233 paragrafi 18 të KPP-s, meqë ka vërtetuar se i pandehuri Sh. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësinë e tij të autorizuar, e për këtë nuk është detyruar nga askush por edhe nuk është shtrënguar në asnjë mënyrë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte relevante të nxjerra nga provat e bashkëngjitura aktakuzës lëndore, e në anën tjetër nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-s (se vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit përbënë veprë penale, se nuk ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale, se nuk ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe se në shkresë të lëndës ekzistojnë prova të mjaftueshme për me të cilat vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit në fjalë si bashkëkryerës kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar sipas aktakuzës lëndore). Dënimi i rekomanduar me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve përkatësisht prej 180 ditëve, i zëvendësuar me dënim me gjobë prej 10,000 Euro është i bazuar në ligj meqë i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit në fjalë por edhe shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprimeve inkriminuese të tij duke marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese të konstatuara në arsyetimin e këtij aktgjykimi

Kryetari i trupit gjykues me rastin e aprovimit të rekomandimit të dënimin sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë marrëveshjes, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese përkitazi me të pandehurin Sh., se i njëjti ka pranuar fajësinë, është penduar për veprimin e pamatur të tij, se ka premtuar seriozisht se në të ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin, se nuk ka qenë i gjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, si dhe se është mbajtës i vetëm i familjes së tij me punën e tij. Rrethanat lehtësuese përkitazi me këtë të pandehur gjykata nuk ka gjetur. Rrethanat lehtësuese të të lartcekura, ashtu të sublimuara paraqesinë rrethanat veçanërisht lehtësuese, andaj edhe gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 lidhur me nenin 72 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të KPRK-s të pandehurit Sh. ia ka zbutur dënimin nën minimumin e dënimin të paraparë, duke ia zëvendësuar në kuptim të nenit 44 të KPRK-s me dënim me gjobë në shumën prej 10,000 Euro.

Mirëpo, nëse i pandehuri Sh. nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s, me vet faktin që është suspenduar dënimi me burgim, janë krijuar kushtet ligjore që këtij të pandehuri t'i zëvendësohet dënimi përtej 180

ditëve, duke ju llogaritur çdo 20 Euro me një ditë burgim. Gjykata e shkallës parë këtë përfundim e ka nxjerr nga praktika gjyqësore e krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, duke u bazuar në aktgjykimin e kësaj gjykate Pml.nr. 259/2019 të datës 05. Shtator 2020. Sipas këtij aktgjykimi në arsyetimin e tij në faqen 4 pasuesi i dytë : “ ... **meqë në momentin e zëvendësimit të dënimit me burgim me dënim me gjobë, dënimi me burgim suspendohet dhe hynë në fuqi dënimi me gjobë (si titull ekzekutiv), kurse në rast të mospërmbushjes së pagesës së gjobës duhet të aplikohen dispozitat e dënimit me gjobë siç është përcaktuar në nenin (46) tani 43 paragrafi 3 të KPRK-s, sipas të cilës dispozitë parashihet se dënimi me burgim i zëvendësuar nga dënimi me gjobë nuk mund të tejkaloj tri (3) vjet. Në rastin konkret dënimi me gjobë i zëvendësuar me atë me burgim nuk e tejkalon tri vite.**

Sa i përket të pandehurit të dytë H. D gjykata ka vërtetuar këto rrethana lehtësuese dhe rënduese : se i pandehuri ka pranuar fajësinë, ka premtuar se në ardhmen nuk do të ndeshet me ligjin, se është penduar për veprimin e pamatur për të cilën është shpallur fajtor. Si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur se : ky i pandehur ka qenë i gjykuar për vepër të natyrës së njëjtë me aktgjykim të plotfuqishëm i cili gjendet në fazën e ekzekutimit. Organi i ndjekjes penale nga Interpoli Tirana ka siguruar informatë zyrtare se i pandehuri H. është i gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër vite e tetë muaj, për vepër të natyrës së njëjtë neni 284/2 TË Kodit Penal, me vendim nr. 91 të datës 27.02 2019 të gjykatës së shkallës parë në Fier, kurse është bërë i formës së prerë me vendimin nr. 315 të datës 16.07 2019 të Gjykatës së Apelit në Vlorë.

Gjykata në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë me provat e paadministruara e të bashkëngjitura aktit akuzues e të çmuara – vlerësuara siç janë raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes, vërtetimit për sekuestrimin e automjetit me të dhëna tjera sim ë lart në këtë aktgjykim, raportit të ekspertizës lidhur me telefonin mobil të të pandehurit Sh. nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë të datës 04.08 2020, raportit të ekspertizës lidhur me fidanet e bimës së cannabis sativa të mbjellura në arën e këtij të pandehuri, të datës 05.08 2020, por edhe fotodokumentacionit nga vendi i ngjarjes, si dhe të rrethanës rënduese të cekur më lart, është bindur se edhe me një dënim minimal të shqiptuar mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-s, duke e parandaluar të pandehurin në fjalë që mos të ndeshet me ligjin por edhe në disiplinimin e personave potencial që mos të kryejnë vepra penale. E njëjta vlen edhe për të pandehurin e dytë.

Gjykata është e bindur se dënimet e shqiptuara të pandehurve në fjalë shprehin gjykimin shoqëror të të pandehurve për veprën penale lëndore, duke synuar në ngritjen e moralit por edhe forcimin e detyrimit për respektimin e të mirave juridike të mbrojtura me të drejtën positive penale.

Gjykata sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka vendosur për konfiskimin e 540 fidaneve të bimës cannabis sativa të cilat janë shkatërruar nga policia në vend të ngjarjes – tek ara e të pandehurit Sh. K, por edhe të automjetit me karakteristika si më lartë si pajisje me të cilën është kultivuar bima e cannabis sativa, edhe atë në kuptim të nenit 272 paragrafi 2 të KPRK-s.

Meqë as në marrëveshje për pranimin e fajësisë e as në aktakuzë nuk është propozuar konfiskimi i telefonit mobil me karakteristika tjera si më lart, gjykata ka vendos që t'ia kthejë të pandehurit Sh. në kuptim të nenit 116 paragrafi 1 të KPP-s meqë nuk ka pasur bazë juridike për konfiskim.

Në kuptim të nenit 368 të KPP-s palët janë udhëzuar për të drejtën në aknesë, kështuqë përderisa i pandehuri Sh. shprehimisht ka hequr dorë nga e drejta në ankesë, aktgjykimi përkitazi me këtë të pandehur është bërë formës prerë më datën 23 shtator të vitit 2020 në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP-s. Po ashtu as mbrojtësi i të pandehurit të dytë e sa ai personalisht nuk kanë paralajmëruar shprehimisht ankesë. Po ashtu i pandehuri i parë është njoftuar edhe për mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë me atë me burgim, duke mos e marrë parasysh dënimin fillestar me burgim pasi që tanimë i njëjti sipas këtij aktgjykimi dhe praktikës gjyqësore të unifikuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me numër dhe datë të lartcekur është i suspenduar.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP, kurse sa i përket taksës është vendosur në kuptim të nenit 39 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr. 92/2020, më dt. 23 shtator të vitit 2020**

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri,d.v.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

VËREJTJE: Aktgjykimi **përkitazi me të pandehurin Shaban Kelmendi** është bërë i formës së prerë më datën **23 shtator të vitit 2020** në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP-s, meqë palët shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.